



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.41.dt.31.03.2000

**MIRATIM FONDI NGA TE ARDHURAT E BASHKISE PER FESTIMIN E 80
VJETORIT TE KLUBIT TIRANA**

Këshilli Bashkiak Tiranë, në mbledhjen e tij të dt.31.03.2000 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Sporteve dhe Drejtoria e Financës “Për miratimin e fondeve nga të ardhurat e Bashkisë për festimin e 80 vjetorit të Klubit Tirana” në mbështetje të ligjin Nr.8114 dt.28.03.1996 “Për Sportin” neni 19 “Klubet dhe Shoqatat Sportive” paragrafi 2, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.7572 dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” dhe të V.K.M. Nr.441 dt.15.08.1994 “Regullore për kompetencat dhe detyrat e administratës të bashkisë e komunës”, pika 10 “Detyrat e Seksionit ose Zyrës së Kulturës, Rinisë, Sporteve e Shoqatave” paragrafi 10/5 dhe 10/6

V E N D O S I

1. Të miratoi fondin prej 2.000.000 lekë për festimin e 80 vjetorit të Klubit “Tirana”
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Sportit dhe e Financës
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI
ORHAN SAKIQI

